

**Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,
Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë kërkon të punësojë 1 (një)
përsone akademik me kohë të plotë të kategorisë Lektor.**

Kriteret përcaktuese janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë Master Shkencor, ose studimet e ciklit 5-vjeçar në një nga degët e fakultetit të Inxhinierisë Elektrike.
2. Nota mesatare (ose e ponderuar) e diplomës ose e secilës nga diplomat e veçanta, në varësi të programit të studimit të jetë mbi 8 (tetë).
3. Nota mesatare në lëndët Matematikë, Fizikë dhe Elektroteknikë të jetë mbi 9 (nëntë).
4. Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë kërkohet që kandidati të ketë gradën shkencore Doktor i Shkencave. Titulli përbën avantazh.
5. Kandidati të ketë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjetik, eksperiencë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor në fushën përkatëse.

Kritere të tjera:

1. Kandidati preferohet të ketë qenë drejtues dhe pjesëmarrës në projekte të ndryshme në përputhje me fushat e ekspertizës së Departamentit të dokumentuara.
2. Kandidati preferohet të ketë eksperiencë në mësimdhënie në Universitet dhe aktivitet kërkimor shkencor në fushën përkatëse të dokumentuara.
3. Të ketë aftësi komunikuese për transmetimin e njohurive të domosdoshme tek studentët të dokumentuara.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **06.11.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.